



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. Br. Prot. Prot No. 01-844/14
 Data Datum Date 12.03.2014
 Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages 02
 PRISTINE

DATË/A:	11.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-05/14
PËR/ZA/TO:	z. Safet Hoxha, Kryetar i Bordit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari z. Hoxha,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe nenit 22 (paragrafi 1 dhe 2) të Rregullores së Punës nr.02/2013 të Agjencisë Kundër Korrupsionit, lidhur me kërkesën tuaj ofron këtë:

O P I N I O N

Ushtrimi i funksioneve publike si Kryetar Bordit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Anëtarit të Senatit në Universitetin Publik të Prizrenit paraqet papajtueshmëri të funksioneve dhe konflikt të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

ARSYETIM

Agjencia kundër Korrupsionit, me kërkesën e z. Safet Hoxha ka filluar procedurën për trajtimin e rastit me numër të protokollit AKK-03-720/14, i cili ushtron funksionin publik si Kryetar Bordit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik si dhe Anëtar i Senatit në Universitetin Publik të Prizrenit.

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se Agjencia kundër Korrupsionit, në bazë të kompetencave të parapara me ligj, bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave, neni 19 (paragrafi 5) i Ligjit Nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në bazë të nenit 8 të këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik, kanë për detyrë të parandalojnë dhe të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit.

Prandaj, pyetja juaj për mundësinë e angazhimit si Anëtar i zgjedhur në Senatin e Universitetit Publik të Prizrenit, krahas funksionit tuaj publik, si Kryetar i Bordit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është paraparë si kufizim në ushtrimin e funksionit publik, që parashihet pikërisht në nenin 16 (paragrafi 1) të këtij Ligji, i cili shprehimisht thotë;

Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit.

Rrjedhimisht në nenin 16 të Statutit të Universitetit Publik të Prizrenit Nr.04-V-621, janë të përcaktuara autoritetet kryesore qeverisëse të Universitetit; Këshilli Drejtues, Rektori dhe Senati.

Ndërsa në nenin 17 (paragrafi 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037, thuhet:

Statuti i çdo universiteti përmban dispozita që i japin Senatit apo një strukturë të barasvlershme përgjegjësi kryesore për këshillim dhe vendimmarrje lidhur me çështje akademike, ku ndër anëtarët e këtij organi janë edhe përfaqësues të zgjedhur të stafit akademik dhe studentë.

Nga ky nen kuptojmë se Senati i Universitetit Publik të Prizrenit është organ menaxhues dhe vendimmarrës për çështjet akademike.

Andaj bazuar në dispozitat përkatëse të lartëpërmendura konstatojmë se angazhimi në cilësinë e Anëtarit të Senatit në Universitetin Publik të Prizrenit paraqet mospajtueshmëri në funksionin tuaj si Kryetar i Bordit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik.

Prandaj, ju rekomandojmë që të veproni konform këtij opinionit për të parandaluar dhe shmangur çdo situatë që mund të sjellë në gjendje të konfliktit të interesit sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Me respekt!